

1914-1  
B. 92

Nonda Bulka

BIJ  
TË SHKREPIT

891.983-1

NONDA BULKA

S

B - 92

BIBLIOTEKA E SHKËTIT  
GJIRKASTËR

~~33247~~

11690

Mëkëta këtu, këtu  
Në qytet, në fshat  
Të përhapur  
Fjalët Krupës këtu

**B I J**

E shikoni vallë  
Pranverën që  
Shpërthet  
Pallatit

**TË**

**SHKREPIT**

Që më 1 të kaluarit më  
Për qytet pak të shprehur  
Përse këtu, përse këtu  
Përse këtu, përse këtu?

Të shikoni vallë  
I shprehur këtu, këtu  
Përse këtu, përse këtu,  
Në këtu këtu, këtu këtu?

Mëkëta këtu, këtu  
Që këtu këtu, këtu këtu  
Të shprehur këtu, këtu  
Përse këtu, përse këtu?

Jef Shkë me fjalë të shprehur  
Shkë me fjalë të shprehur  
Shkë me fjalë të shprehur  
Shkë me fjalë të shprehur

**N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHERI»  
TIRANË, 1963.**

## PARA MONUMENTIT TË SKËNDERBEUT

Kalojnë shqipet varg-e-varg,  
Në qjell'e dlihtë shqipëtar,  
Të përshëndesim pran'e larg,  
Fatos'i Krujës legjendar.

E shikon vallë tokën nënë,  
Pranverën që të ngjatjeton,  
Skifter malësie i padhënë,  
Pulsin e jetës, e dëgjon?

Po nur' i yt kalorës mali,  
Pse duket pak i mallëngjyer?  
Përse tërfillon e s'mbahet kali,  
Më si një lumë i rrembyer?

Dhe syt e tu që si stuhi,  
I kllitnin dërmën ujkut plak,  
Pse sillen ca si më habi,  
Nër male fusha rreth-e-qark?

Mos vallë tymi tej-për-tej,  
Që çan shtëllungë gjer në re,  
Të duket ty, o Skënderbej,  
Se flaka ra mbi mëmëdhe?

Jo! S'ka më zjarr që djeg e pjek;  
S'ka më kurbane, gjaqe,  
Se më çdo fushë e mbi çdo breg  
Ngrihen viganë oxhaqe.

Mos të kujtohet ajo gjëmë,  
Kur nëmëmth Sulltan Murati,  
Shinte mbi eshtra si në lëmë,  
Buzë Osunit, nga Berati?

Kur djemtë e tu të tradhëtuar,  
Binin si lis që pret druvari,  
Me kryet lart e trup-coptuar  
Dhe që s'u mbet nishani, as varri?

Mos sjell ndërmënd ata rrebeshe,  
Kur me hordhitë zullumtare,  
Gjokës më gjokës na u ndeshe,  
Mbi kreshtat tona legjendare!

Kur palla jote vetëtiti,  
Si djell behari lart mbi maja,  
Dhe si kukuth u mbloth jeziti,  
Sikur i ra mbi kokë dambllaja?

Ç'shekull kreshnik i paharruar,  
Kur grise flamën Gjysmë-Hënë,  
Azgan mbi Atin tënd kaluar,  
Gardh ç'më iu bëre Shqipes nënë!

Pse vallë ai syri yt,  
Mbërthehet lart mbi pllaja,  
Atje ku egër u përplas  
Sa-e-sa herë Murtaja?

Trungjet e dushkut a i sheh,  
Nër pyjet legjendare?  
Vazhdat e vijave, i njeh,  
Mbi lëvozhgëzën e çarë?

Janë gjurm' e lotëve rrëke,  
Që rrodhën poshtë fletëve,  
Që shkanë gjatë shekujve,  
Që derdhi korba nënë.

Sa herë nër lëndina,  
Ku zverdhte trendelina,  
Hasi parmend'e bujikut,  
Kokallat e dëshmorit!

Shiko! Diçka po vetëtin,  
Thellë te zemr' e shpatit;  
Dritë elektriku atje ndrin,  
Hidroçentral' i Matit!

Këngë dhe djersë në çdo hap,  
Drita nër zemra u përhap!  
A e dëgjon këngën e re,  
Pulsin e popullit si rreh?

Polem nër mote i panafakë,  
U end pa sy në qorrsokakë,  
Po Yll'i kuq gjumit e zgjoi  
U ngjall ky marathonomak:

Hordhi barbarësh me lloj kryqe,  
Të thyer e të pathyer,  
U dyndën ashpër porsi qyqe  
Me sqepin gjak-përlyer.

U duk se raca jonë u fik,  
Nënoçkës buzë-plasur,  
Ju terrën lotët mbi qerpik,  
Ju piks dhe qumështi në gji,

U tretën foshnjat si qiri,  
U dollën rrudha ballit. . .  
Me tmerr ushtoi, me llahtari ,  
Ulërima e çakallit.

Dhe fishkëllim' e gjarpërit,  
— «U-shojt si shkumb e u bë hi  
Nami dhe emëri i Arbrit! —  
U çduk si dielli në stuhi.»

Por jo! Ky fis nuk ka të shuar.  
Fisi i lashtë i Ilirit  
Mu si feniks i kohës shkuar  
Digjet dhe lind prej hirit.

Kristal sikur shkëlqen një lot,  
Në syrin tënd të ndritur:  
Folë një fjalë -o Kastriot,  
Nuk je duke ëndërritur...

Pse je statujë, ndaj s'po flet?  
Po ti i gjallë je në jetë!  
Ti rron mes nesh, o Skënderbe,  
Në zemrat tona çerdhe ke.

Përmes dragonjve kapedan,  
Në paqe qoftë a në tufan,  
Ajr'i lirisë që të rrethon,  
Ëmbël fytyrën ta lëmon.

Malet, kodrinat rreth e qark,  
Luginat, fushat pran' e lark,  
Shpirtin, çdo gjë ta gufon sot,  
Hero i kombit, Kastriot!

Dhe buz' e Tij sikur u tund,  
Nër qjell fluturoi kali,  
Larg mbi zenithin e pafund,  
Mu si një shqipe mali.

Dëgjo! Majash etherit,  
Sa fort ushton bubllima  
Buçet zër' i Skënderit:  
— U lumtë o kryetrima! —

Kalojnë shqipet varg e varg,  
Në qjell e dlirtë shqipëtar,  
Të përshëndesin pranë e lark,  
Fatos i Krujës, legjendar!

## SHQIPONJA DHE KUÇEDRA

Po flinin Shqiponjat në çerdhen e ngrirë,  
Në gjumë ishin kredhurë malet përpjetë..  
Dremitnin dhe yjtë në qiellin e nxirë,  
Kur zbriti Kuçedra si natë nga retë:

Folet'e Shqiponjës sulmoi  
Dhe shkëmbi shkëndia lëshoi.

— «U pruar l) stuhi e Xhenemit!—»  
Sa fort ushton klithm' e zgalemit!

\* \* \*

Dhe hije e Kuçedrës kukzohet,  
Si bishë e uritur akrohët,  
Spërkatënë vatrat shqiptare.  
Me gjak të Shqiponjës krenare!  
Nga larg po vengon një mandatë!

— «E prenë Shqiponjën e ngratë!  
Ku janë astritat me fletë,  
Që hekurin hanin me dhëmbë,  
Ata që përpinin dhe retë,  
Që shtinin mbi hasmin më këmbë! — »

Jehon' e përzishme mer dhenë,  
Në fusha, lugina, luadhe,  
Përshton kryq-tërthor mëmëdhenë.  
Ushton lumi plak me të madhe:  
— «Ç'u bënë fatosat sy-shkruar,  
Që plumbat i pritnin me duar? — »

Nër dete zinxhirat kërcasin,  
Dhe zemrat marazi pëlcasin:  
Mbi gërxhe, nër hone gremina,  
Zë — çjerrur utrin gjeraqina:

— «E nxinë Shqiponjën e nxinë,  
Nga faqja e dheut po e fshinë!» —

Zgërdhiet Kuçedra e fryhet,  
Me gjak të kulluar po lyhet,  
Dhe zhabat, shushunjat, çakenjtë,  
Lëpijnë nga gjaku i shenjtë.

\* \* \*

— «E vranë Shqiponjën, e vranë! — »

Sokllijnë çobanët në stane.

Vllastarët e dushkut kërcasin,  
Rrëketë me shkumë buçasin,  
Vrapojnë sorkadhet ta qajnë,  
Thëllëzat me vesë ta lajnë.  
Pa dalin Hyritë nga pylli,  
Të lehta, të zbehta si dylli!

Me kuje e lot duke qarë,  
Pa thurin aty mbi lëndinë,  
Dyshek për Shqiponjën e vranë,  
Me fijëza ar-trendelinë!  
Dhe flokët, flori-qelibar,  
I shkulin, i shtrojnë mbi bar,  
Mbulesë për nënën e ngratë,

Së bashku vajtonin me t'madhe,  
Thëllëza, Hyri e sorkadhe,  
Ndërsa në një cep në koriye,  
Murtaja e strukur në hije,  
Qefinin me nge ia qendiste,  
Me vrer e shafran ia stoliste.

\* \* \*

Po ja! Palc' e tokës buçiti,  
Kushtrimi errësirën e çorri,  
Një Yll kuqerrem llamburiti,  
At natë D r i t m a d h e Nëndorit



— «Sulmoni sokola, petrita,  
Kuçedra na shkeli në vatër,  
Agoi për të shtypurin drita,  
Liria nuk ka rrugë tjetër — »

Shqiponja dy sytë lëvis,  
Dhe krahët përplas me furi,  
Kur Mortja karshi qesendis,  
Dhe çfryn mu si ferr në stuhi:  
«S'kam parë si ti kokë-shkretë,  
Nër shekuj mban kryet përpjetë,  
Sa herë afshí im të ka prekur,  
Gjer sot ke shpëtuar, s'ke vdekur;  
Tashti s'më shpëton, do t'të vras,  
Më plase, më fryve maraz». —  
Tomori shpërtheu si tufani,  
Një yll llamburit nga I v a n i !

«Sulmoni sokola, petrita,  
Kuçedra na shkeli në vatër,  
Agoi për të shtypurin drita,  
Liria nuk ka rrugë tjetër!»

U skuq mal 'e fushë e çdo prak,  
U nxi nus'e re në duvak.  
Dhe plagët që zogü ka marrë,  
Si yjëza margaritarë,  
Skalitën mbi gjokës nishanë:  
As qiejt yj të tillë nuk kanë.  
Mbi re një flamur i coptuar,  
Në plumb e barut i pagzuar,  
Çpaloset krenar i pa-dhënë,  
Mburojë e Shqiponjës nënë!

\* \* \*

Dhe sorra, shushunja, zhapinj,  
Çakenj, kukuvajka, gjarpinj,  
Përbindshit nga pas po i vinin,  
Si djej në katran ulurinin.

Dhe rreth e përçark trimes shpëndë,  
Marshojnë dragoj hije-rëndë  
Q'i prin yll' i kuq flakë-zjarr,  
I dlirtë, xixëllonjës si ar.

Përbindsh' i tërbuar tmerrohet,  
Dhe er' e furishme tërbohohet:  
«Në zjarr zogjt' e Shqipës do pjek,  
Shkëmbinjtë me pishë do djeg!»  
Dhe mal' i patrembur përgjigjet:

«Vatani ku linda po digjet,  
Po zëmr' e Shqiponjës si shkëmb,  
S'lë kurrë të shuhet ky vend!  
I njoh këta trima azganë  
Me gjokës e mbrojnë vatanë,  
Sa herë Murtajën e çporrën,  
Me thonj Gjysmë-hënë e çorrën,  
Sa lart kanë mbajtur flamurë,  
S'u ulën më gjunjë, jo kurrë!

\* \* \*

C'po fryn Er'e Lindjes përçark,  
Kuçedra ka rënë në çark!  
Shikoni, shikoni si sulen,  
As hekurit zjarr s'i përkulen!  
Kuçedra çalë-çalë, e shëmtuar,  
Me bisht nëpër shalë e gjymtuar,  
Po prapset e shembur, e thyer,  
Me turp! Duar-gjak çapëlyer.  
Me zë djallëzor prej lubije  
Nga pas belbëzonte një hije:

— «E gjora kuçedër mbarove!  
Me far'e me fis u shkretove,  
Në gjirin kallkan po të marr,  
Së bashku do zbresim në varr.  
Na erdhi të dyjave fundi,  
Jam Mortja! Shqiponja na mundit

Dhe ja! Ca-nga-ca paket terri;  
Çan rrugën mes reve skifteri,  
Dy sy mbi tufan i mbërthen,  
Dhe kënga si dallgë vërshen!  
Një këngë e re dhe e lashtë,  
E fortë, e hidhur, e vrazhdë,  
E brujtur gërmadhash e varre,  
Legjenda e botës shqiptare,  
E shkruar me lavd e me gjak,  
Që lindi në zjarr e në flak:

«— Ç'u ndez ylli i Arbrit, ç'u ndez!  
Shqiponja gjakoset, po s'vdes.  
I mposhti tufanet, rrufetë,  
Shikojeni! Si zbret nga retë!  
Me plagë mbi gjokës qindisur,  
Rreth ballit nishane stolisur.

Ushtuan Vijosa, Shkumbini,  
Dhe Buna, Devolli e Drini.  
U tund kryelarti Tomorri,  
Agimi errësirën e çorri.  
Si yll llamburiti Ivani,  
Nga malet po zbret partizani.  
Buçima u kthye në fjalë,  
Dhe fjala u ngrit lart si valë,  
Që nxorri Polemi nga gjiri;  
Shqiponjës yll-kuqe i thirri:

«Çpalosmi hyjneshë ato flatra,  
Përhap siariqin nër vatra,  
Se çerdhet pranvera i ndriti.»

Dhe palca e tokës gjëmoi,  
Me zë trimëror prej dragoj:  
«Shqiponja ka zemër graniti.»

---

1) U pruar — U kthye përsëri. E përdorin arbëreshët

## VLORA-VLORA

Përmbi shkëmbij e gurë,  
Sa epope u thurë!  
Sa herë plumb-dushmani,  
Çpoi tej-përtej flamurë!

Në shi, furtunë e borë,  
Ç'e fortë ish ajo dorë,  
Ajo që priu flamurë  
Mu në kreshniken Vlorë?

M'e fortë nga çdo dorë,  
Ajo që priu flamurë,  
Flamur që s'jepet kurrë,  
Ish zemrë e bardhë borë!

Zemra që lart e ngriti,  
Flamurin dykrenorë,  
U bë kala graniti  
Në kryetrimen Vlorë!

Kurrë s'u dha kalaja,  
Nër kreshta, gërxhe, maja,  
Prej zemrash ishte ngritur  
Sokolash faqendritur!

Sot mbi shkëmbij e gurë,  
Nër fusha e luadhe,  
Sa lart e mban flamurë,  
Po Ajo Zembr'e madhe!

## S H E L G U

Kur pashë shelgun plak, aty buzë rrëkesë,  
Në zëmr e buhavitur mu zgjua një kujtesë;  
Dhe shelgu murmuriti, kur fletzat leht i tundi,  
— Këtë frymor të rrudhur, mos e kam parë gjëkund?

Më ra nërmënd papritmas: ashtu si në përrallë,  
E puthura e parë. . a të kujtohet vallë?  
Kam dëshmitar të heshtur, shelgun që fërfërinte,  
Dhe hënën endacake, kur gjoksin tënd e ndrinte...

Kaluan dhjetra vjet, mjergull u bë kujtimi,  
Që i thoshim njeri tjetrit — «Për jetë do jesh imi».  
Tallazet e ksaj jete, na hodhën larg-e-larg,  
Nër brigje të papara i rashë botës qark...

Si një thëllëzë mali, maj kalit nusërove,  
Zorkadhezë e plagosur, nënë duvak lotove...  
Mos vallë nonjë pikë, nga lotëzat e tua,  
Që shkisin nëpër faqe. . kujtonte ndofta mua?..

Nga prushi i zemrës djegur, mbet nonjë xixë. . veç hirit?  
Dhe flaka që na diqte si flutur rreth qiririt,  
Krejt u venit e tërë? Ku iku e nga vate?  
Veç shelgut ç'na ka mbetur, nga ëndrra e asaj nate?

Kur endesh rrotull shelgut. . buzë ledhit nënë arë,  
Të çpon diçka në zëmër për dashurin e. . . parë?

## Vargje të harruara

### S I K U R . . .

#### Sikur

Sikur t'isha fllad i erës,  
T'ia lëmoja sy-mëshqerës,  
Gushë, faqe, kraharuar.

#### Ujë burimi

Ujë burimi po të isha,  
Do t'i puthja pa shterruar,  
Ato flokë të pruar.

#### Ato buzë

Ato buzë lëng-qershije,  
Dal-nga-dal do t'i thëthija,  
Sikur t'isha drit' e djellit.

#### Gjoksi yt

Atë gjokës qumësht — borë,  
Do ta prekja pak me dorë,  
Sikur t'isha rrez e djellit

#### Desha

Desha t'isha lis i pyllit,  
Ta pështillja rreth me fletë,  
Atë trup margaritar. . .

Ta kafshoja si një bletë,  
I kllapitur në nektar.

### Brez floriri.

Brez floriri sikur t'isha,  
Ta shtrëngonja atë bel,  
Si çapkën, bandill — rrebel.

### Valz e detit

Valz e detit po të ishe  
Do ia falje pak fakirit,  
Të dy ftonjëzat e gjirit?

### Flakë

Ah. Kur s'jam — o — flakë zjarri,  
Që ta ngrohja pak qyqari,  
Atë trup derdhur mermer...

### Erë trëndafili

T'isha erë trëndafili,  
Mu në zemër do t'i hyja,  
Folezën aty do ngrija,  
Do ia thosha si bilbili.

### Tufan mali

Ah! Që s'jam Tufan i malit,  
Ah! Që s'kam zjarrin e djalit,  
Tej mbi re do ta rrëmbeja,  
Atje lart ku lind rrufeja,  
Do na shkrinin gji — më —gji,  
Zëmrat — o — si me magji.

Ajo

Në je Trim mermë në duar,  
Si një flutur krahë-shkruar,  
Ngjitmë lart nga enden rretë.  
Ku fole kanë rrufetë.  
Dhe në s'je nga ata trima,  
Që s'shkon lart si vetima,  
Pse ngacmon folen e grerës,  
Ku fle zemr e sy-mëshqersës?  
Mos trazo fëngjiyt e shuar  
Që dremitin të harruar...



LIBRARI E SHKOLLËS  
1972/73  
06911

## EIJ TË SHKREPIT

Dimër pranveror

C'lulëzon ky mëngjez prilli,  
C'po ia thotë bandill bilbili;  
Fryn një fllad i lehtë i lehtë  
Del kopeja mu si bletë...  
Kur ja... topi tej nga deti,  
Tundi malin si tërmeti!

C'është ay që rri menduar,  
Me një krrabë nëpër duar,  
Shtang në vend i mallëngjyer,  
Si një shqipe krahë-thyer?  
— Braho Salua një bari,  
Majë malit në vërrin,  
Kullot dhën e kullot dhi,  
Ca të botës, pak të tij.

Frynte fllad atë mëngjes,  
Lart mbi kreshta binte vesë,  
Mbi varg-malet e pasosur,  
Një pranverë e helmatosur  
Ndaj te zëmr'e çoban Brahos,  
Rëndë dimri pat pllakosur.

«— Kundra teje kush po shtie,  
Nëna ime Shqipëri?  
Bregut detit kush i bie,  
Kush m'i trëmbi desht e mij?»

Rëndë-rëndë pyet Salua,  
Egër-egër lehte Balua,

Nga mazgalla e nga vrima,  
Mbi varg-malet e pasosur,  
I përgjigjet Suferina,  
Si një grifshë e shindosur:

**Ulërin Adriatiku,**  
Valë-shkumë,  
Dhe jehona ngjitet malit,  
**Zbret në lumë,**  
Edhe reja pisë sterrë  
U përflak,

Përsëri trualli i Arbrit,  
U përgjak!

### Endërra

Dhe bariu zëmërlënduar,  
Ndjen një lëmsh në kraharuar,  
Na i çfaqet zëmërthyer  
N'ëndërr nën'e tij e ndyer.  
Dhe ata sy si shqipe malit,  
I mbërthen te syt e djalit.  
Dhe i thënka rëndë-rëndë:  
« Tek po dergjësja te gropa,  
M'u bë se dëgjova topa,  
Dhe të pashë ty o bir,  
Duarkryq mbaje sehir.  
Bir-o Braho — as më thua,  
A je burrë, a je grua?  
Pra braktis kope e stane,  
Shko atje nga po del flakë;  
Ose vish këto çiltjane,  
Edhe tirqet m'i jep mua,  
Se nga varri do të ngrihem,  
Korba u një copë grua,  
Zvarrë-zvarrë do të hiqem,  
Do vulos nga gryka topa,  
Sa ta marë vesh Evropa,  
Se ky vend shkëmbinj e gurë  
Nuk i jepet hasmit kurrë!»

## Revolta

Sikur zëmren çoban Brahos,  
Njëqind thika të ia çponin,  
Kurrë aq rëndë s'do ia lëndonin.  
Kundron Balua i habitur,  
Coban Brahon flokëngritur,  
Ay burrë që s'pat qarë,  
As në helme, as në djep,  
Lotët fshehur sot gëlltet.  
Sokëllin me zë rrufe  
Kur shikon aeroplanin  
Mu si korbën nënë re.  
— Zbrit te sheshi i mejdanit,  
O këlysh pjell'e shejtanit!  
Një hesap të vjetër kemi,  
O qafir' o qen bir qeni.  
Nga ç'moçale vjen o breshkë,  
Që po endesh mbi kto bjeshkë?—  
Edhe qenin ia ndërse:  
— «Kape Balo, s'është zhgabë!—»  
Dhe me grushta dhe me krrabë  
Det e qiell kërcënon.  
Hidhet Balua të sulmojë,  
Po s'ka krahë të fluturojë,  
Dhe çobanit zemër-enjtur  
Mu në syt e tij të vrenjtur,  
Egër ç'i spikat tufani!  
Dhe pastaj i vrazhdë, i vrazhdë,  
Shkon andej nga po del flakë,  
Ku një popull i tradhëtuar,  
Po vadit rrugët me gjak.  
S'kish dyfek, as kishte pallë,  
Po rrufe fshih në qepallë.

## Vdekja

Dhe ndërsa po udhëtonte,  
Me një trastë hedhur supit,  
Ec e ec dit' edhe natë,  
Gunë-grisur, bukë-thatë,

Syt'i vanë vetvetiu,  
Majë Qafës së Koçiut.  
Ndofta solli ndërmënt tanë,  
Kur me trim Selam Musanë  
Ra dëshmor atje në Vlorë,  
Mitroloz' e itajjanit  
E mbërtheu si div me dorë.  
Dhe na ra dëshmor i vrarë,  
Por askush nuk ia di varrë.  
Pastaj Brahua iku, iku...  
Andej tej nga vij armiku,  
Në gremina monopate,  
Më s'u muar vesh nga vate.  
Atë dre-kaproll të malit,  
Thonë e shtriu breshk'e moçalit.  
Po askush haber s'ka marë  
Ku pushon ky lab i marrë.

## Vajtim

Mbi shkëmbinj e nër pllaheja  
Nis e blegërin kopeja.  
Blegërijnë nëpër shkrepja  
Dhent'e gjora, dhit'e shkreta:  
— Si na la bariu të gjorë? —  
Psherëtijnë e psherëtijnë  
Deshtë e sqeptë me këmborë.  
Si jetim kuiste Balua  
«Ku më vajti Braho Salua?»  
Qan e shoqja në kasolle:  
— «O behar, ç'Dimër na solle!  
Na nxirose për së gjalli,  
O dushman të nxiftë djalli!  
Korba u e qyqja u  
Mbeta vetëm si kërcu,  
Si më le të ve, o burrë,  
Mos-më-keq, lumë-e-përrua,  
Djaln-o keq të sëmure,  
Ç'të bëj u një copë grua?  
Me Astritin pesëvjeçar,  
As të gjallë, as në varr?»

## Buzëqeshja

Dhe Astriti shikon nënën,  
Lehtë-lehtë e ndjen gjëmën,  
Por s'mer vesh se ç'u ka ngjarë,  
Ky kërthi fytyrë-tharë  
Buzëqesh, dhe i sëmure  
Ky djalosh kock'e lëkurë,  
Që t'i japë zemër nënës,  
Të ia zbus' helmin e gjëmës.  
Mes furtunës rreze dielli  
Iu duk nënës se ra nga qielli  
Një shkëndi në sy në sy spikat:

— Do jetoj për ty Astrit,  
Të hakmerresh për tët atë,  
Të preç hasmin me sëpatë, —  
Bebz'e Labes — egër ndrit...

## Zë i Padëgjuar

Nër zinxhira Shqipëria!  
Zjen nga brenda vegjësia...  
Në Nëntor dyzet e një,  
Del një zë, e ç'farë zë!  
Ish Kushtrimi i Partisë!  
Edhe shkëmbi mori zjarr!  
Mu si kalë i harbuar,  
Turfullon i egërsuar,  
Çdo fashist, çdo tradhëtar!

## Simfoni e gjakut

Don ta dish ç'ishte stuhija?  
Pyet ckërkat, shkrepat, brigjet,  
Kodrat, gërxfhet, çukat, shtigjet;  
Dhe ata do të rrëfejnë,  
Si u shkrua historia!  
Pyet majat e Cukalit,  
Ku sulmonte ajk'e djalit.  
Pyet shkrepat e Ivanit,  
Ku fole kish shqipe malit,

Pyet shpellat e Zarelit,  
Ato grykat t'Therepelit,  
Shko e pyet nga Tomori,  
Thellë gjer në Çermenika,  
Dhe atje do të të thonë,  
Se si bijtë e këtij vëndi  
As që dinin ç'është frika.  
Shko e pyet nër lugina,  
Kur e rrihte Suferina.  
Dhe ato do të tregojnë,  
Se si binin ata trima

I dëgjon lumenjtë tanë,  
Netë dimri kur vërshojnë?  
Nëpër këngë e nër legjenda,  
Epopen' ata tregojnë,  
Këng'e tyre vaj-lavdi,  
E brumosur në stuhi,  
Kapër xen kufi e det,  
Ngjitet sipër del mbi ret.  
Përshkon botën an'e mbanë,  
Dhe shpërthen nër oqeanë  
Dhe kudo tregon, tregon...  
Se ky popull buzë detit,  
Kurrë nuk iu trëmb tërmetit!

### Ballada e Zanavet

Pa dëgjo si ligjërojnë  
Shtojzovalle n'ato pyje,  
Xixëllojnë pors i yje,  
Gush' e tyre me verojka,  
Lehtë-lehtë është rrethuar,  
Dritë e hënës atë gjokës,  
Me ergjënt e ka mbuluar.  
Me dy sy shkëndia ari,  
Sumbulla margaritari,  
Ja ç'tregon ajo Perri  
Derdhur flokët si flori:  
«—Atje thellë, te përroi,  
I kam parë ata dragoj,

Kur me ferrin na u ndëshën  
 Gryka-grykës u përleshën,  
 Mortja vet u zu ngushtë,  
 Kur kundronte bijtë e nënës  
 Që barut hanin me grusht;  
 Dhe e ngjirur grykë-tharë,  
 Çirresh Shtriga me llahtarë:  
 «Me këta s'ia dalkam dot  
 ....Zot-o-zot.....  
 Ky na qenka popull xhind  
 Bije një, ngrihen një qind.»

### Fjesa e dytë

#### Astriti po rritet

U çporr Dimri... ra Pranvera,  
 Po fryn filladi lehtë-lehtë  
 Çdo mëngjes,  
 Dhe nga qielli lart mbi kreshta  
 Bie vesë.  
 Qesh pranvera n'horizont  
 Të pambaruar,  
 Tërë zëmren e Astritit  
 Ka pushtuar.....

#### Korbat veshur me flori

Po një natë pus, të rëndë,  
 Aty rreth dyzetënendë,  
 Nat'e thellë Shënëndreu,  
 Bir i shkrepit sokëllin,  
 Aqë fort sa tundet dheu.  
 Ç'po kërkon ai bir çobani  
 Fillikat, krejt i vetmuar,  
 Mu në gji t'atij tufani,  
 Që po frynte i tërbuar?  
 Mu në zëmër t'atij pylli,

Astrit Brahua kokë-krisur,  
 Kërkon dhinë e arratisur,  
 Kërkon dhinë laragane,  
 Pra ka dälë asaj korije;  
 Nër kullusma, si një hije,  
 Veç. . gjëkundi gjurmë dhije. .  
 Kur ja! Thellë në një guvë,  
 Pa një zjarr dhe ngriu në vënd;  
 Na hyn brënda n'atë shkëmb,  
 Përmes flakës sheh një burrë,  
 Që po rripte një lëkurë,  
 Pa menduar shumë thellë,  
 Kalli kokën tej në shpellë,  
 T'armatosur gjer në dhëmbë,  
 Tre hajdutë-brrof-në këmbë!  
 «—Pse ma morët — o kusarë,  
 Dhinë time lara-lara? —»  
 Fjalën djali s'e pat sosur,  
 Një hajdut i armatosur,  
 Iu përgjegj me butësi:  
 «—Hyrë brënda, çun i ri,  
 Sa për berën laragan,  
 Ta paguajmë, o çoban!»  
 Dhe si kalit të pangrënë,  
 Befas-befas kurr i vënë,  
 Plot një trastë me tagji,  
 Birit Brahos të habitur  
 I vringëlloi para hundës  
 Një qese plot me flori. .  
 — Hyrë, hyrë, mos ki frikë. . . —  
 — Qënki shumë pasanikë. . .  
 — Sot flori, nesër «liri»,  
 «Hyrë brënda a i vrarë,  
 Jemi «p u r o» shqipëtarë»  
 — Ia ktheu çunij vrazhdë-vrazhdë:  
 — U skullos në atë grazhd:  
 Atë «puro» u s'e pi,  
 As e ha atë tagji —  
 është e hidhur a i vrarë,  
 Qofshi puro «Shqipëtarë»  
 «— Dëgjo çoban kokë-derr,



Për një dhi mos ki qeder,  
 Ne të blejmë një kope  
 Dhi e dhën, e lopë e qe,  
 Për «flamur» të bëjmë be...»  
 Fët-e fët guni ia pret:  
 — Për ç'flamur? Ju s'keni një  
 po d y z e t?.....»  
 Dhe me vrap ai poshtë then,  
 Po tre plumba e mbërthyen,  
 Një e fshiku mu në ballë,  
 Një i dyt e përcellojti.  
 Lehtë lehtë mbi qepallë,  
 Dhe një tjetër më i rëndë,  
 Iu ngul thellë mu në këmbë...  
 Bir i shkëmbit ish plagosur,  
 Po me zëmër qe brumosur,  
 Çan korrijen tatëpjetë  
 Kapërzen drrizat, murrizat,  
 Si kaproll kalon rrëketë,  
 Gjaku çurrkë, po s'u ndal:  
 Kur me vrap kur mengadalë,  
 I kapitur eshtra-mpirë,  
 Zuri fshatin ndaj të gdhirë.  
 As i vdekur as i gjallë,  
 Me zorr nxori këto fjalë:  
 — Atje tej n'atë mazgallë,  
 Thellë shkëmbit më të çarë,  
 Janë fshehur tre trathtarë...»  
 Mbylli syt i rraskapitur,  
 Plumbi rënd e pat goditur,  
 Veç se Mortjes grabitqare,  
 Edhe nuk ju dha përfare.

## Brigadjer Astriti

Ç'është ai fytyrë-ndritur,  
 Poshtë pillajës duke zbritur,  
 Kryet lart e synë prush?  
 Kush të jetë vallë, kush?  
 Brigadjer që prinotë pari,

Që heq lehtë këmbën zvarrë,  
Nishan plumbi mbi qepallë,  
Një të fshikur nënë ballë?  
Kush të jetë vallë kush  
Ky bari mbi gjith i pari,  
Mos u ngrit Brahua nga varri?

Shih Astritin sa u rrit,  
Buckaran e sy petrit  
Dhe mustaqja bir-cobanit  
Ca nga-ca po i dërsit.

\* \* \*

**Tamam  
si i ati**

Si lis derdhur shtati,  
Tamam si i ati,  
I biri Xha Brahos,  
Me krrabë në dorë,  
Me fyell në brez,  
Në shi e në borë,  
Ç'na ecën serbes,  
Mbi çdo brigadjer  
I pari qëndron,  
Në xhep abetaren,  
Nga pas ndjell manaren  
Ç'ma ka synë pishë,  
S'lejon korb as bishë,  
Që çerdhën shqiponjës  
T'ja nxijë, e t'ja prishë.  
Çdo ujë e çakall,  
E pret e përçuell,  
Me plumb mu në ballë.

**Veterani**

Në trungun e dushkut në stan,  
Dremit Balua plak veteran;  
Dhe dhëmbët e prehtë i ranë,  
Dhe këmbët e shpejta e lanë...  
Po prapë i rëndë na mbahet

Kopesë s'i ndahet s'i ndahet...  
 Dhe sa plagë në trup që ka marë?..  
 Në ndeshjet me bisha kusarë:  
 Tregojnë sa shumë beteja,  
 Ka dhënë mër shkrepa e pllaheja.  
 Në mbrëmje nërsa dhëntë flenë,  
 Lëshon syt e zës mbi kopenë,  
 Dhe thotë me vete habitur:  
 — Sa shumë na qënkerka rritur!  
 Pastaj rri menduar-menduar..  
 Kujton ndofta kohën e shkuar,  
 Kur tërë kopeja në stan,  
 Vajtonte mavrinë çoban,  
 Q'u çduk pa lënë gjurm' e nishan  
 Kur këngës Astriti ia thotë,  
 Një kënge të ngrohtë, të ngrohtë,  
 Mendon Balua plak me vetvete  
 Ndërsa lëvis bishtinë lehtë:  
 — Përse çoban Brahua më parë,  
 Ia drithte gjithmonë me të qarë?  
 Sërisht lëviz bishtin gëzuar,  
 Mos ndofta dhe ky ka kuptuar?..

## Simfoni pastorale

Astriti i parë nër male,  
 Ç'na prin një kope blegtorale,  
 I biri Xha Brahos krenar  
 Na qënka m'i pari dhenar.  
 Sy-shkambë po ecën Astriti,  
 Se rrugën Partia ia ndriti  
 Dhe syt i mbërthen ky çoban,  
 Drejt rrugës që populli çan.  
 Nga larg sjell jehona mbi male,  
 Buçima traktorësh nër ara,  
 Në fshatra me hydrocentrale,  
 Nië popull po ecën përpara.  
 Marshon me besim vegjëlia,  
 E prin ngadhnjimtare Partia,  
 Aty më të zbardhur mëngjez,

Kur rrezja varg-malet i ndez,  
Astriti më fyell ia thotë,  
Një kënge të ngrohtë të ngrohtë...

— «Në pyll çpo ia thotë bilbili,  
Me vesë po lahet trifili,  
Aromë përhap trëndelina,  
Çan qiejt me vrull gjeraqina.  
U çporr nga ky vënd Dimri i rëndë  
Kur bujku zvarrit mbi parmëndë,  
Kur sorrat e qiellit çobanit,  
Ia trëmvinë delet e stanit.  
Shiko si lulzon Shqiprija,  
Që kurrë s'u pa tjetër herë,  
Shiko si një popull jet gjatë,  
Q'u ndrydh mote e shekuj buk thatë,  
Po ecën drejt rrugës shpëtimit,  
E prin ajo dritë e Leninit?»  
Kështu Astritë Brahua ia thotë;  
Një kënge të ngrohtë — të ngrohtë.

## NJË E ÇMËNDUR NË FURTUNË

### Përbindshit

Në një katund të vogël në jug të Shqipërisë,  
Çizmeja gjak-përlyer e egër e Prusisë,  
Shëndroi në hekatombë një kopsht të lulëzuar,  
Në varr të madh e ktheu, at fshat të përgjëruar,

Dhe kjo ndodhi atje,  
Në vitin dyzet e tre.

Asnjë qenie e gjallë, hordhive s'u shpëtoi,  
Dhe dallg'e kuqe gjaku vërsheu porsì përroi.  
Stuhia e shpërthyer i grreu një nga një,  
Të gjithë: gra e burra, foshnja dhe çiliminj.  
Në fshat një heshtje e thellë e varrit llahtarisë,  
Hitleri kishte sjell «paqën» përmes kërdisë.  
Xhelatët që po qeshnin me harmonium, me kor,  
Blatuan një këngë tmerri, një «Te Deum» mizor.  
Me maja bajonetash kërcnonin trupat shtrirë,  
N'atë luginë skëterre që këlliste drithëtirë.  
Dehur e kafshëruar nga krime të pa ngjarë,  
Shkuan duke kënduar Deutschlandin «luftëtar».

### Njerëz dhe kafshë

Dhe zogjt e llahtaruar që muar arratinë,  
Dy ditë më vonë u kthyen, çuditur cicërinë,  
Se më s'i panë gjëkund fëmijë n'argëtime,  
Q'u zgjatnin ëmbël dorën mbushur me plot thërrime.

Si panë ato kufoma llahtarshëm përcëlluar,  
N'thertoren e përbindshit nën uniformë shtrënguar:  
—«Të egër qenkan njerëzit!» — Thanë me zë habije,  
Dhe rrahën krahët, hikën ndaj brigjesh lumturije.

Vetëm dy shpëtuan

### Zboraksi

Askush s'i shpëtoi flakës  
Si dallgë zjarri ngritur,  
Veç një voglush zborakës.  
Edhe një vajz'e mitur:  
Zboraksi drithëronte  
Në flakën q'e rrethonte.

Kënga e zogut

«—Të gjitha shkumb e hi,  
Përveç një shelgu t'dendur.  
Pran tij vajza e çmendur.  
Ndaj qante shelgu i zi.»

Zogu krahët përçuli,  
Një drithmëz'e përshkoi,  
Mbi sqepnë që e uli  
Kënga e tij pushoi.

Jorgjeta

Vogëlushja e mjerë, o vaj,  
Kish Mortjen pranë saj,  
Po Mortja u dhëmbsurua,  
Më pranë ju afua,  
Dhe ëmbël e rigadalë,  
I pëshpëriti kto fjalë:  
— Pëshilla mir' e mirë,  
Në këtë tym të nxirë,  
T'shpëtosh pa të diktuar,  
S.S.-ët e tërbuar.

Dhe ja! N'ato gërmadha, mes dherave të nxirë,  
 Dëgjohesh të lëvrinte diçka në errësirë,  
 N'atë përzjerje tmerri, kockash me llom e gjak,  
 Dy syçka t'engjëllushes xixllonin pak nga pak!  
 Afrohen: kruspull mbledhur rrëzë shëlgut degë-dendur,  
 Të mjerën vajzë-lule e gjejnë gjallë e çmendur!  
 Mbi ballin mavijosur, rrudhosur e trishtuar,  
 Dalloheshin ca shenja prej plumbash fshikulluar...  
 Dhe syt e zgurdulluar ja ngulte qjellit sterrë,  
 Nga buzët ç'i kullonin pik-pikë gjak e vrer...  
 Me shpirt e trup përgjakur e varfëra krijesë,  
 — Mëshirë! — bëlbëzonte — O vrasës të pabesë! —  
 Ç'i përsëriste dendur pa rreshtur, atë fjalë  
 Se miqtë, q'u afruan i mori për vandalë,  
 Ishin fjalët e fundit të prindve të shkrumbuar,  
 Të vetmet që pat ngulur ndër mënd nga ç'kish dëgjuar.  
 Kurora përmbi kokë me gjëmba e lule ferra,  
 Dëshmonin çmendurinë dhe lot të ksaj humnere. .

Se si një vajzë e mitur çmëndet plasur më nj'anë,  
 Veç ju mund ta kuptoni, ju o nazistë gjermanë!

## Epilog

### D a s m a

Dhe vitet shkuan shkuan,  
 Dhe kohët krejt ndryshuan.  
 Shtatëmbëdhjet vjet plot,  
 S'ka më vaj, zi e lot!  
 Borova lulëzon,  
 Shqipëria dritëron.

Në jug të Shqipërisë,  
 Në një katund të vogël,  
 Po qeshin dhe këndojnë,  
 Ç'po dehen dhe vallzojnë.  
 Kremtojnë me madhësi  
 Dasmën e asaj vajze,  
 Që pa picëri e zi,  
 E lumtur gjithë nur,

Eh ç'nuse, deli nuse,  
Mu si thëllënxë fushe,  
Ajo qënka vërtet  
Që pa atë rremet.  
Dhe ditën e kurorës,  
Si rrezja përmes borës,  
I ndrijnë syt e shkruar,  
Pasqyrë e vërtetë,  
Një zemre të gëzuar.  
Por ja, mes vellos-tuli,  
Mbi ballin që e uli,  
Ca shënja i vëreje  
Prej plumbash batareje.

Dëshmi që s'ka të shuar,  
Një krimi t'paharruar.

---

Shënim: Kjo vjershë është shkroftur në frëngjisht dhe botuar në revista të huaja. E ka përkthyer në shqip Prokop Gjergo.



## FLET PARTIA

Kur sulmonte pik'e djalit  
Majë malit,  
Dhe kur pisha e vandalit  
Digjte foshnjatë në djep,  
Dil një zë nga palc'e tokës  
Shqipëtare,  
Dhe përplasësh mbi armikun  
Si batare:  
«— Bjeri më të lumtë dora,  
Bëjë fëra!  
Jam me ty si mish e thua,  
Mos u trëmb se më ke mua.» —  
Kush flit kështu, ndërsa fryn  
E çfryn stuhija?  
Flit Partia!

Dhe kur hasmi i xhalavitur  
Shkumëzonte i lebetitur,  
Dhe me thik'e me litar,  
Çdo pëllëmbë dhe një var...  
Kush buçit përmes tërmetit  
Mu si dallg' e fort 'e detit?  
«Popull mos iu trëmb stuhisë,  
Po agon dit'e lirisë!  
Ishte zëri i Partisë.»

Mbi gërmadhat ndriti djelli,  
Mijra yj xixëllon qjelli  
Ç'u përmbys kjo bot'e vjetër,

Duhet ngritur bota tjetër,  
Bota jonë, pa padronë!  
Cep më cep buçet jehona,  
Oshëtin dhe mal dhe det.  
Përsëri Partia flet!  
Ja! Në fshat llamburit dritë,  
Dhe shkëmbinjtë po rrëzohen  
Thellë që nga themelitë!  
Djersë, këngë në çdo hap  
Edhe lumi u bë zap!  
Pa u thanë plot moçale,  
Pa u çanë plot kanale,  
Dhe po ngrihen mbi lumenj  
Hidrocentrale.

Kush i dhë vrull punëtorit?  
Kush i dhë zjarr kraharorit  
Të lëvizë pistoletin,  
Goxha shkëmb ta hedhë n'ërë?

Kush po sjell ndër ne pranverë,  
Një pranverë të paparë  
Tjetër herë?

Buzë Vjosës, anës Bunës  
Lavdi Ty, Parti e Punës!

## BUÇET LUMI

Pse buçet ky lum'i Matit?  
Pse ushton jehona shpätit?  
Dallg'e thirjur shkumëzor,  
E gjëmon!  
Vallë ç'mund të ketë ngjarë?  
Kush e di ç'häber ka marrë!  
U hap lajmi vetëtimë  
Në Tiranë:  
— «Dritë, jetë vegjëlisë,  
Anembarë!» —  
Fjal'e dalë prej Partisë,  
Buzëqesh foshnja në sisë,  
Ndaj buçet ky lum'i Matit,  
Kur me vrull vërshon prej shpätit.  
Po flet lumi, rëndë-rëndë:  
«— Gjer më dje si i tërbuar,  
Udhëtoja i harbuar,  
Mbillnja tmer, përhapja zi,  
Më mallkonte plak e i ri.  
Një nga një do laj gjynahet.  
Gjithë fajet!  
Sot e tutje tërë populli  
Kreshnik,  
Do më quaj — «Lumë-mik!  
Shëkuq duke udhëtuar  
Sa kam par'e kam dëgjuar...  
Sa kujtime...  
Fsheh e ruan zemra ime!  
Mu ne der'e fukarasë,  
Pashë vdekjen të trokasë!  
Pranë foshnjësë pa gojë,  
Pash' Urinë të përgjojë,

Pashë nënën të lotojë.  
Shkuan shekuj...  
Shkum' e bardh' e valës sime,  
U bë gjak!  
Kujë, vajë, shkatërrime  
Më çdo prak.  
Dhe një ditë...  
Nëpër qiej të Shqipërisë  
Zbardhi drita e Lirisë!  
Pashë kullën e bajrakut  
Të rrëzohet.  
Pashë vatrën e bonjakut  
Që të ngrohet!  
Dhe atje ku Met Zogolli  
Varfëri e skamje mbolli,  
Sot i jepet vëndit dritë.  
Që nga Mati në Mirditë,  
Peshkopi e Krujë Shkodër  
Po ndriçohet fush' e kodër,  
Myzeqe, Fier, Berat,  
Çdo fabrik' e kombinat!  
Sipër malesh bie borë,  
Po, s'të ngrin;  
Ulërin tufan nër pyje  
S'të mërdhin,  
Ja! Po fryn një tjetër erë,  
Dimri kthehet në Pranverë!  
Po kush vall më jep kuvet  
Të zgjerohem sa një det?  
Unë plak të bëhem djalë,  
Të lëviz hydrocentralë?  
Gjegjet bjeshk' e malësisë,  
Gjëmon zër'i vegjëlisë;  
— Ndihm' e madhe e atij popull  
Sovjetik  
Zëmrën ton' e bën çelik;  
Shkëmb-granit është Partia,  
E çeliktë Miqësial,  
Gumëzhin krenare vala,  
Malësis'i çon të fala.

## BIR I VEGJELISË

— Ti luan bir vegjëlë.  
Ku ke qënë,  
Qindra vjet që s'të ka parë  
Vëndi tënë?  
Kur errsira kish pllakosur  
Dhe kur nata s'kish të sosur,  
Kur as qjelli s'kishte yje,  
Kur mbulontë mugëtira,  
Mal'e pyje,  
Ku ke qënë? —

— Nëpër pranga kam jetuar  
I munduar!  
Në farmak e vrer i zhytur,  
Gadi në skëtërrë mbytur,  
Po i gjallë, jo i vdekur  
Zëmër-hekur!  
Shpesh zinxhirat i kam tundur,  
Male, dete, kam lëkundur,  
Dhe si mbytesha në gjak,  
Më shkëlmonte ujku plak.

Në një natë të Nëndorit  
Fort të ngrirë,  
Kur zvarritesha i-mpirë  
Në zinxhirë,  
Një shqiponjë sy-petriti,  
Me dy krahë prej graniti,  
Mu ne shtrofka e mjerimit

Më trokiti:

— Ngreu skllav, të erdhi dita,  
Për të verbrit zbardhi dita,  
Jam me ty si mish e thua,  
Eja pas se më ke mua! —  
Dhe u zgjova! Dhe lëftova!  
Gjaku det, po e fitova!  
Copë-copë, u bë zinxhiri,  
Ish Partia që më thirri!

Mbi një vatër të nxirosur,  
Mbi një truall të shkrumbosur,  
Mbeta zot!  
Po kasollja e zhuritur,  
Duhësh ngritur!  
Dhe ky vënd duhesh vaditur,  
Jo me gjak e jo me lot,  
Po me djersën e të zot!  
Ndaj tanë po, çaj tunela  
E bëj malin thela-thela,  
Thaj kënetë, hap kanale,  
Ngre me vrull hidrocentrale.

Dhe kjo baltë,  
M'u bë mjaltë!  
Se një yll më ndrin përpara,  
Mbi traktorët nëpër ara,  
Nënë tokë, në minierë,  
Atë yll e shoh përherë:

Emri im? Ç'e do të dish?  
Mija, mija në se ç'jemi,  
Veç një emër neve kemi:  
Jemi ajk' e vegjëlisë  
Shtyll' e hekurt e Partisë!

## VAJZA DHE LULJA

Në fushat e pambukut, thëllënxëza mitare,  
Ç'ia thotë gëzim-plotë, një kënge lozonjare!  
Dhe mu si bor' e malit zbardhon një fush' e tërë  
Ashtu si zbardhëllojnë ato të dyja llërë,  
Që lulen e pambukut këpusin lehtë-lehtë.  
Dhe lulja e mërzitur sy-zezës i ankohet,  
Ngadalë, ëmbël-ëmbël, fillon t'i pëngjërohet:  
— «Pse më venit pranverën pse më këput të shkretën?  
Jam gonxh' e re akoma, tashti po gëzoj jetën!»  
Ndërsa mpleks një gërshet,  
Vasha fillon e flet:  
— Për ty tani nis jeta, o lule bukuroshe,  
Kur ti bashkë me shoqe do futesh nëpër koshe.  
Pa do spastrohesh mirë, do krihesh e do lahesh,  
Si vajz' e përkëdhelur do mburresh e do mbahesh.  
Me salltanet do hipësh pastaj n'otomobil,  
Do hysh si nus' e bukur në Kombinat' tekstil.  
Do nisësh e stolisësh si flutur ngjyra-ngjyra.  
Sa nuk do të të njihet as trupi as fytyra.  
Krenare, madhështore do rritesh e do rritesh.  
Në fshatra e qytete, në male lart do ngjitesh.  
Me ty do zbukurohen dyqane madhështore,  
Do të shkëlqesh m'e bukur nga stina pranverore.  
Pëlhura, dok, këmisha, prej teje do të dalin,  
Do veshësh të gëzuar si plakun, si dhe djalin.  
Dhe gocës nazeqare do t'i dhurosh fustane  
Me kinda an 'e ane.  
Rinija jote lule, tashti pora fillon...  
Shiko! Një fshat i tërë për ty kremton, këndon.

## MUJO ULQINAKU

Ç'janë ata që nxijnë detin?

E dëgjon, nëno, tërmetin?

— Jan' hordhitë e dushmanit,

Për t'i vënë zjarr vatanit

O birol

— Ç'janë ata këmishë-zes,

Që po vinë aq serbes,

Me ca pupla si këndes.

O nëna ime?

Ata janë mizëria,

Që po vinë me zinxhira,

Të na lidhin këmb' e kokë,

E ta kthejnë varr 'e gropë,

Çdo luath, çdo fush' e pyll,

Do nxirosinë çdo yll!

Pa do bushin me kufoma,

Me kufoma, ah, të njoma

Çdo kodrin' e çdo hendek

Mal më mal e breg më breg.

— Zjarr nga deti, zjarr nga qjellil!

Nëno, u sterrua djellil!

— Durrës ty, o Durrës plak,

Hasmi po të shkel në prak,

Populli u mbyt në gjak!

Ç'po lëfton një ulqinak.



Lëfton djali, lëfton plaku  
Gjer në gju na vate gjaku,  
Bjeri Mujo Ulqinaku  
Për liri!

Lufton populli i arbreshit,  
Si dikur me pallë sheshit  
Për Shqipri.

Thrret Guzzoni: Mamma mia,  
Ç'burra paska Shqipëria!

Telegramet ven' e vinë  
Nga Llondoni në Athinë,  
Nga Belgradi n'Amerikë,  
Nga Azia në Afrikë;  
Nga Parisi gjer në Moskë:  
Çpo luftojnë geg' e toskë.  
Për një truall për një prak,  
Lahen rrugëtë me gjak!

Kush lufton ashtu më këmbë?  
Kush ha hekurin me dhëmbë?  
Janë trimat shqipëtarë,  
Që po heqin zorrët zvarrë!  
Të tradhtuar nga një mbret,  
Q'u degdis për në kurbet!

Është Mujua, një kapter,  
Që lufton e ydes me nder!

Dhe ja plumb' i mallëkuar,  
Tej-për-tej në kraharuar!  
Ç'na u mbyt trimi në gjak,  
Për një truall, për një prak,  
Nëna më të madhe qan,  
Kur sheh shtrir' atë luan:  
— Gjirin ta kam bër' hallall,  
Xhan o shpirt, me yll në ballët  
Ti m'u vrave për liri,  
Ndaj të qan një Shqipëri,  
Bir o bir si lumthi ti!

## SHKËMBI I SHQIPONJAVE<sup>1)</sup>

Nëpër gërxbet e Mirditës,  
Po i hapet rrugë Dritës!  
N'ato male ku sundonin  
Markagjona,  
Shkrep më shkrep gjëmon jehona:

— Hapu shkëmb, mos ha inat!  
Mjaft e mbajte kryet lart!  
S'i sheh krushqit e dasmorët  
Që për Ulëzë po shkojnë?  
Lumin venë të martojnë!  
Kjo s'ish parë as në ëndërr,  
Që ta nisin lumin dhëndërr!  
Po ti qënke kokë-shkëmb  
Ndaj vendosa të të shëmb,  
Shkëmb o shkëmb! —

Hem krenar, hem i hutuar,  
Ja kthen shkëmb' i zemëruar:

— Mijra vjet në këto rrëza,  
Plot me çerdhe për thëllëza,  
Shqipe mëlesh e skifterë  
Kam strehuar:  
Po askush nuk ka guxuar,  
Të më thotë: «Luaj vëndit!»  
Sikur t'isha pend' e shpendit!  
Ti djalosh me pistolet  
Me kë matesh, kujt i flet?  
Unë jam Shkëmb' i shqiponjës! —

1) Këtë emër mban shkëmbi më i math që u hoth n'erë për hapjen e rrugës së Dritës, bazë kumit të Matit.

— Edhe unë o kokë-shkëmb,  
Jam një minator sulmonjës! —

Dhe fitilit i dha flakë,  
Shpell' e tërë u përflak:  
Oshëtin thellë lugina,  
Po kremton tërë krahina,  
Ç'po na hapet rrug' e Dritës!  
Mes-për-mes nj'asaj Mirditës!  
Cop' e thrime rrokulliset,  
Shkëmbi plak tej në luginë,  
Si errsira që zvarriset  
Në greminë.

**KËNGË LABERISHT**

Kurvelesh, zëmëra ime,  
Kurvelesh.  
Ç'janë këto bombardime,  
Kurvelesh!  
Kurvelesh-o-gur e shkëmb,  
Kurvelesh,  
S'ka mortajë që të shëmb,  
Kurvelesh!

← Këngë labërishte,  
Këng' e zëmrës s'ime,  
Ç'po më ngjall sërish  
Sa e sa kujtime...  
E ëmbël, e vrazhdë,  
Mbi kto malet tona,  
Ç'po ushton ndër shekuj  
Si rrufe jehona.  
O këng' e brumosur,  
Në lavdi e vaj,  
Me shpirt të brengosur,  
Krenohem e qaj. →

— Kush je ti shqiponj' e malit,  
Q'i ke dhënë sisë djalit  
trim me fletë,  
Që ka varrin atje poshtë  
Te rrëketë? —  
←Lart mbi ato brigje,  
Tej nër ato shtigje,

Në shi e në borë,  
Atje ku kullosin  
Deshtë me këmborë:  
Ligjëroj krenare,  
Këngë shqipëtare.  
Fyellit i bije:  
Këngë trimërije,  
këngë labërije! →

— Mos je ti në këto rrëza,  
Plot dragoj, dhe plot fëllëza,  
Që këndon e qan astritë  
Pallë-xhveshur,  
Nga ata që dhe me Mortjen,  
Ballë për ballë janë ndeshur? —

— Qindra vjet më parë,  
Ç'lemeri kam parë!  
Kafshatën kam ngjyer,  
Në lot e farmak.  
Kur digjej kasollja,  
Kur prishej kopeja,  
Më dukesh së binte,  
Zjarr-rrufe nga reja.  
Po s'u dhashë kurrë,  
E kam zëmren burrë,  
Nëpër këto çkërka  
Edhe vetë gratë,  
Kur ndjejnë mandatë,  
Bëhen si nepërka,  
Ndaj këndoj krenare,  
Tokën shqipëtare.

Këndova Gjolekët,  
Që me pallë sheshit,  
Prinin në kto gryka,  
Bijt' e Kurveleshit.  
Qava Bilbilejtë,  
Që si kapedanë,  
Në litarë vanë,  
Që të trembëdhjetë: →

— Kush je ti moj krahë-erë,  
Buzë shkrepit me skifterë,  
Që heq ison zvarrë-zvarrë,  
I këndon dragojt të vvarë,  
Si një dhëndrri me kurorë  
Kur shkon nusen për të marrë? —

— «Jam bij e vatanit,  
Jam afsh' i tufanit,  
Jam flokëz' e borës!  
Djali më ka rënë,  
Në luftën e Vlorës,  
Tjetri me tre plumba,  
Gjoksin plagë-shkruar,  
Në kto gërxië rrotull,  
Për Parti e popull  
Jetën ka dhuruar! —»

— Kush ta ka stolisur,  
Ballin si shteg mali,  
Atë trup t'hazdisur,  
Kush vallë ta fali?  
Kush të ka qindisur  
Me at ngjyrë ergjëndi,  
Kush ta çelnikosi,  
Zëmrën mu si shkëmbi? —

— Zëmrën si stuhija,  
Ma farktoi Partija!  
Ngjyrën e fytyrës  
M'a dha drit' e hënës!  
Shtatin e hazdisur,  
M'a dha gjir' i nënës!  
Syrin m'a qindisi,  
Pënda e pëllumbit,  
Nishanin e ballit  
Një e fshikur plumbit!  
Kur u zhytën malet,  
Në tym e në gjak,  
Ç'u ndez zëmra ime  
Si barut në flak!

Pra nisi stafijsa  
Ç'u tund Labërija!

Flakëruan vetëtimë  
Këto maja nga mortaja.  
Dhe gjëmoi, Dhe kërcënoi.  
E egërsuar,  
Gryk 'e Kuçit Gryk 'e keqe:  
Kurrë hasmit s'i tha: peqe!  
Pra na shkeli këmb' e huaj  
Këtë baltë  
Që me lot e gjak vaditur,  
Është e ëmbël mu si mjaltë.  
Bora që zbardhonte malet,  
M'u duk porsi një qefin,  
Që mbulonte vëndin tim.  
Kur m'u hap toka si varr,  
Kënga ime mori zjarr!  
Copë u bë këmishëziu  
Gjak-përlyer,  
Në greminë u rrokullis.  
Dhe kryqi-thyer.  
Po breshk' e moçalevet  
Rrëzoi dren' e malevet!  
Dhe kënga në grykë,  
M'u duk se shterroi  
Tej nga lindja hodha sytë,  
Pashë si shkëlqenin yjtë:  
Përmes mijra mijra dritave  
Në qiell,  
Pashë Një që xixëllonte,  
Porsi diell!  
Rrez' e tij plot frymëzime,  
I dha zëmër, zëmërë simel!  
Bir' i shqipes u rilind,  
Binte Një; dilnin një qint!

Dhe kur muzgu nisi e bije,  
Varem poshtë si një hije,

Shkoj e shmallem buzë përrojt,  
Pranë varrit të herojt.  
Brenga zëmrën ma ka marrë  
Për petritin tim të vrarë.  
Shumë malli më ka zënë,  
Për petritin tim të rënë.  
E kam djalë, më ka nënë!

Sot këndoj pranverën,  
Qiellin pa re,  
Diellin, lulet, erën,  
Një botë të re!  
Sot këndoj kopënë,  
Fushën, Myzeqenë,  
Pa zgjedhë, pa bej  
Tërë atdhenë e dashur.  
Tej e përkëtej.  
Këndoj ëmbël-ëmbël,  
Fushat plot blerime,  
Ligjëroj e qetë  
Lumin dhe rrëketë,  
I kam gjak ndër deje,  
Gjak të zëmrës sime.  
Atje mbi kodrinë  
Këndoj dashurinë.  
Kur na vjen pranvera,  
Pa zë lëmon era  
Flokëzat e mija,  
Rri pranë çapkenit.  
Që pret majë lëmit  
Dhe këndon brengosur:  
«Dil moj qën' e qënit,  
Se plasa i gjori,  
Këtu majë lëmit!»  
Me të hyr' të prillit,  
I lutem bilbil:

— «Tregomë dhe mua  
Nga këngët e tua,  
T'ia këndoj në krua,  
Asaja që dual» —



Ligjëroj krenare,  
Botën shqipëtare,  
Fusha, pyje, male,  
Që mbushen me dritë,  
Me hidrocentrale.  
Sot këndoj Partinë,  
Lavdinë, lirinë,  
Jetën, lumturinë,  
Lule Shqipërinë.  
Jam Zana e paqës,  
Jam Zana e jetës,  
Këng' e së vërtetës.

Shqipëri zëmëra ime,  
Shqipëri,  
S'ka tashti më bombardime,  
Shqipëri!  
Kush guxon të prek një qime,  
Shqipëri,  
Bëhet copë e bëhet thrime,  
Shqipëri.  
Shqipëri e fortë shkëmb,  
Shqipëri;  
S'ka mortajë që të shëmb,  
Shqipëri!

Dhe nënën xhalavit  
Nga gjiu zëmrën ia ç'qit!  
Ia çkul zëmrën e artë,  
E shtjell në një cop' kartë,  
Dhe si i çmëndur del:  
Mbi dhe këmba s'i shkel.  
Asgjë rrugës s'shikon,  
Veç syt'e gjarpërushës,  
Ata veç ëndërron!  
Kur po vraponte në sokak,  
Gremiset, qorrolliset,  
Rrëzohet, mbytur-gjak.

Ahere ngjau ajo që ngjau...  
Dhe guri i sokakut  
I mallëngjyer qau!  
Dhe kur po jepte shpirt,  
Në vesh dikush i pëshpërit:  
— M'u vrave shumë o xhan, o shpirt? —  
Kish folur zëmr' e nënës!  
Kish folur zëmr' e artë.

E bardhë je o borë,  
Mbi malet si kurorë,  
Kur djelli të shëndrin!  
Po ti o zëmr' e nënës  
M'e bardhë vetëtin!  
E fort' është rrufeja,  
Që shkrepëtin nga reja,  
I fort' është oqeani,  
Kur e tërbon tufani,  
Po dashuri e nënës,  
Qenka m'e fort' akoma

M'e lartë nga çdo mal,  
M'e bukur nga çdo yll,  
M'e ndritur nga çdo diell  
Që vezullon në qiell,  
Edhe nga drit' e hënës  
Veshur n'ergjënd e ar,  
Na qënka zëmr' e nënës.

## VALA DHE DJALI

— Ti o valë e bardhë e bardhë,  
Shkumbë — bore përmbi det,  
As më thua nga ke ardhë,  
Aq me vrull e salltanet?

Zhurmëmadhe vinj nga larg,  
Ngre stërkallat sa një mal,  
Shkumëzot rreth — e përçark,  
Gjëmë — madhe jam o djalë!

— E kujt bijë je ti valë,  
Që na hiqesh aq krenare,  
Që buçet aq e furishme,  
Si një breshër me batarre?

— Jam e bija e Tufanit,  
Dal nga gjiri i Oqeanit:  
Po ty çun azgan sy-det,  
Që serbez me mua flet,  
Syt të tu ku t'i kam parë,  
Mos je fis ti me detarë?

— Ish një natë Shënëndreu,  
Kur im atë më tregonte,  
Si në det ai peshkonte,  
Sesi ujët shkumëzonte,  
Egër deti nxinte nxinte,  
Barkën donte ta përpinte.

Më në fund n'atë përlëshje,  
Ja për jetë ja për vdekje,

Ai doli fitimtar!  
More vesh tashtī o valë?  
E kam babën marinar.

— Ku ta dish ti çun i mitur,  
Sesa trima kam gëlltitur,  
Sesa nëna kanë qarë,  
Sa të rinj e sa të thinjur,  
Në gji tim e kanë varrë!..

«— Dëgjo valë e furishme,  
Ti që je aq e fuqishme,  
Atin tim mos ma trazol!  
E kam shpirt, te dua shumë,  
A dëgjon valë me shkumë?  
Më premtol.....»

Ushton vala, ulërin,  
Asnjë fjalë s'pipëtin...  
Prap i flet djaloshi trim:  
— Heshtja jote nuk më trëmb,  
Se im atë e ka zëmrën  
Më të fort nga një shkëmb!  
Në çdo ndeshje do të dalë  
Fitimtar,  
More vesh o valë e thinjur,  
E panginjur,  
E kam babën marinar!

## FLUTUROJNË SPUTNIKËT

Fluturojnë sputnikët krenarë,  
Nëpër qiellin e kaltër pa re,  
Hapësirën pa fund kanë çarë.  
Për njerinë ç'e madhe myzhde!

Edhe yjtë më fort xixëllojnë,  
Mysafir' e papritur sodisin,  
E vështrojnë, e vezhgojnë, e kundrojnë,  
Dhe me dritën e artë e qendisin.

Dhe sputniku përçark po vërtitet,  
Stratosferën e kthen në xhade,  
Rruzullimi i tërë mahnitet,  
Për njerinë ç'e madhe myzhde!

Pyet ylli me dritën e artë:  
— «Mysafir q'hapësirën përbuz  
Nga na vjen, si u ngjite aq lart?  
—«Vij nga toka-Sovjetskij Sojuz!»—

Jam shkëndia e shkencës, e paqës,  
Hapësirën dhe kohën përbuz,  
Jam pranverë që i jep erë manushaqes,  
Mesazher nga Sovjetskij Sojuz!

## SHËRIM I SIGURT

U mblodhë doktorë  
Grumbull shkencëtarë.  
Kolonialistin shkuan për ta parë,  
I shikuan trupin, i panë dhe gjakun,  
I preknë pak dellin, i hapën stomakun,  
I panë dhe trurin,  
Kokë-e-këmb'e panë  
Tërë të sëmurin  
Dhe pastaj i thanë:  
— Aty pranë gjirit,  
Sëmundje Misirit,  
E therur e mezit,  
Sëmundje Suezit;  
Trubullir e trurit,  
Ramatizm e gjurit,  
Janë që të dyja,  
Sëmundje e Vajgurit...  
Thellë mushkërivet,  
Ethe e Kollonivet:  
Mu në gjak moj xhanë,  
Analiza thotë:  
Sëmundje Kubane. »  
Ashtu si ish shtrirë  
Duke psherëtirë,  
Kolonialisti  
Pëshpërit ngadalë:  
— Vuaj nat e ditë,  
Qafsha kolonitë,  
Ç'farë djalli të jetë,

Kjo sëmundje shkretë.  
— Sëmundje tipike,  
Kapitalistike!  
— Cili është ilaçi  
Që të shkojë e keqja?  
— Një ilaç i hidhur  
E çuajnë... Vdekja!

O ti në arrati i çakërditur,  
Në gjuhën e dëshpërimit të lehtë,  
Le të shprehësh këmbë-krye nëpër kulturë,  
Dhe i pengojmë turpin dhe bukë.

Mbi gjewain vula-vula i dënkësuar,  
Tërbërit me të gjakë të rëndësuar,  
T'vuluen nëjtë-ogjytë mbi lëkurë,  
Si hajratë, gjakë të rëndësuar.

E shite Fejzambetin me florë: (1)  
Në Vatikan të blisur një Not i ri,  
Po mësëti të gëlli tërë luletë,  
Të nxjerrësh nëmëndë dhe Popën vetë.

Në dorë të çakës, në dritë të lujë,  
Po sillësh hendesëk rring-mërrugë,  
Nubat tëpinë e përën të den përzen,  
Kokallat që të bëjnë padron dollarë.

Për vendin ku je bërë në dritë,  
Qëlin me dorën tënde keq po dritë,  
Qëndrues nëjtë-rotullë me anë,  
Se vjetër në të bë pishë, o merrëncanë.

1) Nëse kripet e diversitetëve në Tiranë ka datë se diç më tërë,  
narrë epigramë, ndërrim janë për të holla.

## RUBAIRA PËR TË DAMKOSURIT

O ti në arrati i çakërdisur,  
Në grazhdin e dushmanit je hazdisur,  
Je shtruar këmbë-kryq nëpër kulltukë,  
Dhe i pangopur, turpin ha me bukë.

\* \* \*

Mbi gjoksin vula-vula i damkosur,  
Tradhtinë mu në gjak e ke rrënjosur,  
T'valviten ngjyra-ngjyra mbi lëkurë,  
Si hajnali, d y z e t e ca flamurë.

\* \* \*

E shite Pejgamberin me flori: (1)  
Në Vatikan të bleu një Zot i ri,  
Po nesër ti je gadi për kuletë,  
Të nxjerrësh në ankand... dhe Papën vetë.

\* \* \*

Në dorë një çanak, në brez një lugë,  
Po sillesh hendacak rrugë-më-rrugë,  
Nuhat, lëpin e brren si qen pazari,  
Kokallat që të heth padron dollari.

\* \* \*

Për vendin ku je tundurë në djep,  
Qefin me dorën tënde sot po qep,  
Qëndise rreth-e-rrotullë me ar,  
Se vet në 'të do hysh, o mercenar.

---

1) Nga gjyqet e diversantëve në Tiranë ka dalë se disa mercenarë shqiptarë, ndrruan fenë për të holla.



## PRITJE TRIUMFALE 1)

Na u nis mister Niksoni  
Shpejt e shpejt nga Vashingtoni,  
Tërë gaz;

Mori edhe gruan pas.  
Shkuan drejt në Venezuelë  
Dhe ndërsa po udhëtonin  
Burrë e grua kuvendonin:  
— Ti s'e di, ë dashur grua,  
Se sa bukur do na presin,  
Ty e mua;

Pa dhe rrugën do na shtrojnë  
Me qilima Arabije,  
Oh sa fort do na nderojnë  
Bash ashtu si na ka hije.  
«—Ububu gjithë ky millet  
Që ka dalë te po na pret!»—  
N'atë çast një kungulleshkë  
Paf, përplaset në vitrinë,  
Një domate dhe një pjeshkë  
Diplomatit puf në shpinë!

— «More burrë, shpirt o xhan,  
Ç'është kjo domate e kuqe  
Që m'u ngjit mu në fustan?»—  
— «S'janë lule, karafille,  
As burbuqe, trandafille!»

Njerëzit e thjeshtë thrrësin:  
— «Monopolit të dollarit  
Vendin tonë nuk ja shesim...  
Me patate dhe domate

**Miqësinë me Vollstritin  
Përshëndesim!—**

\* \* \*

**Asaj dite, asaj nate  
Gjith'qyteti i Karakasit  
Ish në kriz' për zarzavate,  
Se i hëngri sirr Niksoni  
Mysafir nga Vashingtoni!**

---

1) Shumë diplomatë të Shteteve të Bashkuara që kanë vizituar Amerikën Latine, janë pritur shumë keq prej popullsisë.

## BRESHKA DHE VANGARDI (1)

Një përrallë rreth sputnikut,  
Tej matanë Atlantikut,  
Po kalon gojë më gojë:  
Grumbull-grumbull fotografë  
gazetarë,  
Ishin mbledhur për të parë,  
Satelitin me raketë,  
Kur do ngjiteshe përpjetë  
Lart mbi retë.  
Ndërsa pritnin fluturimin  
Gazetarët hanin, pinin.  
Na kalon aty një breshkë  
Dalngadalë,  
Hiqesh zvarë çalë-çalë,  
Sateliti rëndë-rëndë  
E shikon breshkën dhe thotë:  
«—Ç'e ka nxjerrë perëndia  
Në këtë botë  
Këtë kafshë aq të plogtë?  
Krahasoheni me mua:  
S'më harrin as gjer në thua.  
Unë jam vetëtim' e botës,  
Ajo është plesht i tokës.»  
Çkulet gazit e zgërdhehet,  
Breshka urt e but i kthehet:  
— Me kë qesh, o kokë-pjeshkë?  
— Qesh me ty, o zonja breshkë,  
Qesh me shpejtësinë tënde.  
Ç'djall të solli në këto vende?  
Nuk e di se kush jam unë?  
Më pagëzuan Bebe-lunë<sup>2</sup>).

Do të ngjitem lart në qiell,  
Do të dritëroj si diell,  
Pa do hidhem me vërtik,  
Do kaloj në shpejtësi  
Dhe sputnikun sovjetik.»—

Gjegjet breshka:

«— Nga kto anë un kam parë  
Kshu si ti edhe të tjerë,  
Q'u pat marë koka erë;  
Po m'e shpejtë un'kam qenë  
Nga të gjithë sa do ngjiteshin  
Në Hënë.

Ndaj dhe ty po të çpall garë  
Kush do vëjë më përpara  
N'atë arë.

Dhe pa nxjerrë tjetër fjalë,  
Niset breshkë dëlgadale,

.....

Bum-bum-bum, plas një raketë  
Sateliti në vënd mbetë.  
Breshk'e vogël zuri arën  
Sateliti i Uallstritit  
Humbi garën.

- 
- 1) Sputniku amerikan, që dëshmoi në provat e para.
  - 2) Hëna e vogël.

IBLIOTEKA E SHK  
GJYKONJES

33248

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Para monumentit të Skënderbeut .....	3
Shqiponja dhe Kuçedra .....	7
Vlora — Vlora .....	12
Shelgu .....	13
Sikur .....	14
→ Bij të shkrepit .....	17
— Një e çmëndur në furtunë .....	29
— Flet Partia .....	33
Buçet lumi .....	35
Vajza dhe lulja .....	39
Mujo Uliqinaku .....	40
→ Shkëmbi i shqiponjave .....	42
Këngë labërishte .....	44
Legjenda e një zëmre .....	50
Vala dhe djali .....	53
Fluturojnë sputnikët .....	55
Shërim i sigurt .....	56
Rubai për të damkosurit .....	58
Pritje triumfale .....	59
Breshka dhe Vangardi .....	61

Redaktor: Idriz Basha  
Pikturor: Doli Gjini  
Korrigjor: Arif Lashani  
Redaktor teknik: Adnan Lajç

Shkup, 1980

Formet 78 x 109/32

Tirazhi 1800

Shkup, N. S. P. Shtypshkronja "MIHAL DURI" - Tirana